



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI RREGULLATOR

Tiranë më	01.11.2024
Nr.	3124

Data: 1.11.2024

Nr: 11

Ora: 14:00

VENDIM

PËR

MIRATIMIN E LISTËS SË DOKUMENTACIONIT QË KËRKOHEM PËR TË VËRTETUAR QËNDRIMIN E ZGJEDHËSIT SHQIPTAR QË VOTON JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, ME QËLLIM REGJISTRIMIN NË LISTËN E ZGJEDHËSVE JASHTË VENDIT

Në mbështetje të nenit 20, pika 1, shkronja “dh”, nenit 25, pika 5 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

V E N D O S I:

KREU I. Rregulla të përgjithshme

- Zgjedhësi për regjistrim në listën e zgjedhësve jashtë vendit paraqet dokumentacion që vërteton qëndrimin e tij jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
- Adresa e shtetasit që voton nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë mbështetet në një nga dokumentet që paraqet në KQZ sipas pikës 5, të nenit 25 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe sipas kreut II, pika 1 të këtij vendimi.

KREU II. Lista e dokumentacionit që kërkohet për të vërtetuar qëndrimin e zgjedhësit shqiptar që voton jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim regjistrimin në listën e zgjedhësve jashtë vendit.

- Gjatë paraqitjes së kërkesës së tij për regjistrim në listën e zgjedhësve jashtë vendit sipas rregullave të miratuara nga Komisioni Rregullator, zgjedhësi ngarkon në Platformën Elektronike

Data: 1.11.2024 Nr: 11
Ora: 14:00



“Për miratimin e listës së dokumentacionit që kërkohet për të vërtetuar qëndrimin e zgjedhësit shqiptar që voton jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim regjistrimin në listën e zgjedhësve jashtë vendit”

të Regjistrimit (PER) të paktën një nga dokumentet e listuara më poshtë që vërteton qëndrimin e tij jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë:

- a. dokument pronësie ose ekuivalent i lëshuar në shtetin e rezidencës, që provon pronësinë e banesës;
 - b. dokument që provon rezidencën në shtetin e huaj, i lëshuar nga autoritetet përkatëse;
 - c. kontratë qiraje ose huapërdorje të banesës;
 - ç. dokument/e bankare (kontratë kredie, vërtetim bankar etj), që përmban adresën e banimit;
 - d. kontratë furnizimi ose faturë të furnizimit me ujë në banesë;
 - dh. kontratë furnizimi ose faturë të energjisë (gaz ose elektrike) në banesë;
 - e. kontratë ose faturë të abonimit të shërbimit digjital të transmetimeve audiovizive;
 - ë. kontratë ose faturë të ofrimit të shërbimit të internetit/telefonisë fikse në banesë;
 - f. leje drejtimi automjeti (patentë), në rastet kur shënohet adresa e banimit;
 - g. dokument të lëshuar nga organi kompetent i shtetit ku ka vendbanimin, i cili vërteton qëndrimin e zgjedhësit në një institucion shëndetësor, kamp emigracioni, apo tjetër të ngjashëm;
 - h. ose çdo dokument tjetër, i lëshuar në shtetin e huaj, që provon qëndrimin e shtetasit shqiptar në adresën e vetëdeklaruar jashtë vendit.
2. Numri i shtetasve shqiptarë të regjistruar në të njëjtën adresë, që aplikojnë në Platformën Elektronike të Regjistrimit (PER) për regjistrim në listën e zgjedhësve nga jashtë vendit, nuk mund të jetë më shumë se 6 (gjashtë). Vetëm për shkaqe të përligjura, dhe pas paraqitjes së dokumentacionit provues ligjor, PER do të lejojë regjistrimin në të njëjtën adresë të më shumë se 6 shtetasve shqiptarë.

KREU III. Dispozita të fundit

1. Ngarkohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, si dhe çdo organ shtetëror shqiptar sipas parashikimeve të nenit 24, pika 3 të Kodit Zgjedhor, me detyra për zbatimin e këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë, brenda (5) ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjana NANO

Kryetar

Arens ÇELA

Anëtar

Dritan ÇAKA

Anëtar

Helga VUKAJ

Anëtar

Muharrem ÇAKAJ

Anëtar